



QKSS

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

BAROMETRI KOSOVAR I SIGURISË EDICIONI I GJASHTË

Dhjetor 2016



**National Endowment
for Democracy**

Supporting freedom around the world

Interpretimi i të dhënave:

Mentor Vrajolli, hulumtues i lartë

Redaktimi i brendshëm:

Dr. Florian Qehaja

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Të drejtat e pronës intelektuale mbrohen me *ligjin për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta*.

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme elektronike apo të transmetohet në çfarëdo forme apo mjete elektronik, mekanik apo tjetër pa lejen me shkrim të botuesit. Nuk lejohet shfrytëzimi komercial i të gjitha materialeve që botohen nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) pa lejen me shkrim të QKSS-s. Ju lutem kontaktoni në: info@qkss.org ose +381 38 221 420.

Perceptimet e paraqitura në këtë raport janë përmbledhje e përgjigjeve të nxjerra nga të anketuarit ku ata demonstronjë mënyrën se si ata i shohin institucionet e përfshira në studim. Ato në asnjë mënyrë nuk paraqesin ndonjë vlerësim përfundimtar të punës së institucioneve të matura. Megjithatë rezultatet e tilla gjithsesi shërbejnë si instrument për adresimin e mangësive të mundshme sa i përket performancës institucionale, por edhe si tregues i funksionimit të komunikimit të institucioneve në fjalë me qytetarët.

Pikëpamjet e paraqitura në këtë raport janë perceptime të të anketuarve dhe jo-domosdo korrespondojnë me botëkuptimet e Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë. Gjithashtu, pikëpamjet e shprehura në këtë raport në asnjë mënyrë nuk përbëjnë pikëpamjet e fondacionit National Endowment for Democracy (NED).

MIRËNJOHJE:

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) ju shpreh mirënjohje të veçanta ekipit hulumtues në terren për kontributin e tyre të çmuar. Ekipi hulumtues i Barometrit Kosovar të Sigurisë për vitin 2016 përbëhej nga:

Koordinatorët e Programit dhe Metodologë:

Mentor Vrajolli dhe Tringa Naka

Trajnerë të hulumtimit në terren:

Donika Emini dhe Skender Perteshi

Koordinatorët e hulumtimit në terren:

Skender Perteshi, Donika Emini, Vesë Kelmendi, Sofije Kryeziu dhe Leonora Aliu

Zyrtarët për futjen e të dhënave:

Bardha Maxhuni, Rudinë Jakupi dhe Arife Muji

Ekipi hulumtues në terrenit:

Argjira Kameri, Albinë Bricori, Andi Emini, Arian Mavriqi, Adnan Krueziu, Bardh Krasniqi, Blerta Krasniqi, Blerinë Ukshini, Dardan Naka, Diellza Kosumi, Doruntina Shabani, Donat Breznica, Erna Buçaj, Elona Krasniqi, Flandra Osmani, Florent Gashi, Gojart Jashari, Gëzim Stavileci, Hafize Jashari, Kushtrim Mustafa, Marigona Dubovci, Rina Koleci, Rita Nushi, Taulant Boshnjaku, Valëza Mjeku, Valton Ismajli dhe Valmire Imeri.

Verifikimi i cilësisë së hulumtimit në terren:

Vesë Kelmendi dhe Skender Perteshi

PËRMBAJTJA

MIRËNJOHJE:.....	3
LISTA E SHKURTESAVE.....	5
ÇKA ËSHTË BAROMETRI KOSOVAR I SIGURISË?	6
Kujt i drejtohem me këtë raport?	6
Ndikimi.....	6
Metodologjia	6
BAROMETRI KOSOVAR I SIGURISË (BKS) 2016: GJETJET KRYESORE.....	8
KAPITULLI I:.....	10
1. BKS 2016: BESIMI NDAJ INSTITUCIONEVE TË SIGURISË DHE TË DREJTËSISË	10
1.1. Besimi ndaj institucioneve të sigurisë	10
1.2. Besimi ndaj institucioneve të drejtësisë	12
1.3. Besimi ndaj kuvendit dhe qeverisë së Kosovës.....	14
KAPITULLI II.....	16
2. BKS 2016: PERCEPTIMI I QYTETARËVE NDAJ RREZIQEVE DHE KËRCËNIMEVE	16
2.1. Kërcënimet e brendshme ndaj sigurisë kombëtare	17
2.2. Kërcënimet e jashtme për sigurinë kombëtare.....	19
BIBLIOGRAFIA	22
Burimet e dorës së parë:.....	22
Burimet e tjera:.....	22

LISTA E SHKURTESAVE

AKI	Agjencia e Kosovës për Inteligjencë
BE	Bashkimi Evropian
BKS	Barometri Kosovar i Sigurisë
EULEX	Misioni Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë
FAK	Forcat e Armatosura të Kosovës
FSK	Forca e Sigurisë e Kosovës
KFOR	Forcat e NATO-s në Kosovë
NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior
NED	Fondacioni National Endowment for Democracy
PK	Policia e Kosovës
QKSS	Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

ÇKA ËSHTË BAROMETRI KOSOVAR I SIGURISË?

Barometri Kosovari i Sigurisë (BKS) është program i veçantë i Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS), i cili ka për qëllim që të dal me një publikim të përvitshëm mbi perceptimet e qytetarëve. Më konkretisht, qëllimi kryesor i BKS-s është që ta masë perceptimin e opinionit publik për institucionet e sigurisë dhe të drejtësisë. Njëkohësisht, KSB mat perceptimin publik lidhur me kërcënimet e brendshme dhe të jashtme ndaj sigurisë së Kosovës. BKS-ja është ndër nismat e para dhe më të mëdhatë të iniciuara, realizuara dhe publikuara nga një organizatë vendore. Ajo që e veçon KSB-në, QKSS-ja nuk ka kurrfarë kufizimi politik sa i përket komunikimit të gjetjeve dhe të mesazheve që mëton t'i përçojë. Për fund, BKS-ja është unike sa i përket qasjes metodologjike, duke i integruar metodat kuantitative dhe kualitative me synim të ofrimit të rezultateve sa më reale sa i përket perceptimit të publikut karshi çështjeve që lidhen me siguri.

Kujt i drejtohem me këtë raport?

BKS-ja i drejtohet akterëve të ndryshme, të cilat janë të interesuara t'i përcjellin trendët e opinionit publik në fushën e sigurisë dhe të drejtësisë. Rrjedhimisht, ndër të tjera i drejtohet hartuesve të politikave në Kosovë dhe në Ballkanin Perëndimor, organizatave ndërkombëtare në Kosovë dhe selive të tyre, organizatave vendore dhe ndërkombëtare të shoqërisë civile, qarqeve akademike dhe mediaeve.

Ndikimi

Ndikimi i BKS-s pritet që të shumëfishohet në një periudhë afatmesme për një varg arsyesh, siç janë (a) besueshmëria e QKSS-s si një organizatë politike, jo partiake, dhe e pavarur; (b) përvoja e dëshmuar e QKSS-s në zbatimin e metodave të duhura shkencore gjatë hulumtimeve të veta; (c) rëndësia e pronësisë vendore; dhe (d) kapacitetet profesionale që i ka QKSS-ja. Në gjitha edicionet e mëparshme, BKS-ja i ka përmbushur synimet e lartpërmendura.

Metodologjia

Edicioni i gjashtë i BKS-s është një përmbledhje e besimit të qytetarëve ndaj institucioneve të sigurisë dhe të drejtësisë. Në veçanti, e ka matur perceptimin e publikut kundrejt problemeve dhe shqetësimeve të brendshme dhe të jashtme të sigurisë, si dhe kundrejt problemeve në lidhje me të ardhmen e FSK-së dhe të pranisë ndërkombëtare në Kosovë.

Përgjigjet ndaj pyetësorit të BKS-s janë marrë përmes intervistave në terren, të cilat janë realizuar anembanë Kosovës. Shumica e pyetjeve kanë qenë të llojit të mbyllur, dhe përgjigja mund të jepej sipas modelit të Likert-it prej pesë shkallëve. Disa pyetje ishin të hapura, të cilat ua mundësonin të anketuarve ta jepnin mendimin e tyre pa u kufizuar në opsione të përcaktuara më parë. Përcaktimi i mostrës, pilotimi dhe intervistat u zhvilluan prej ekipit të QKSS-s, i cili përbëhej prej 27 hulumtuesve të terrenit. Mostra gjithëpërfshirëse në nivel vendi, prej të cilës është realizuar hulumtimi, përbëhej prej 1,093 amvisërive, duke u pasuar prej një mostre përfaqësuese të popullsisë së moshës mbi 18 vjeçare në Kosovë. Ndarja sipas përkatësisë etnike e pjesëmarrësve të intervistuar ishte si vijon: 86.9 për qind shqiptarë të Kosovës, 7.0 për qind serbë të Kosovës, dhe 6.1 për qind pjesëtarë të bashkësive të tjera (1.4 për qind turq, 0.6 për qind boshnjakë, 0.9 për qind romë, ashkali, dhe egjiptianë, dhe të tjerët janë goranë, kroatë dhe malazezë).

Korniza e mostrës është e bazuar në kodin zonal të telefonisë, dhe si rrjedhojë përbëhej prej 7 rajoneve: Ferizaj, Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë, Pejë, Prishtinë dhe Prizren. Faza e parë e grupimit gjeografik u bazua në raportin e regjistrimit civil në Kosovë të vitit 2011, ndërsa në fazën e dytë grupimi i mostrave është bazuar në komunat përkatëse duke përfshirë këtu edhe shtresëzimin rurale/urbane, si dhe gjithashtu duke marrë për bazë numrin e amvisërive. Ndërsa në fazën e fundit grupimi i mostrës është bërë duke marrë për bazë metodën e rastit, respektivisht duke e përdorur metodën e ditëlindjes më të përafërt me ditën e mbajtjes së anketës. Përcaktimi i mostrës sipas rastit siguron që secili banor i Kosovës të ketë gjasë të barabartë që të përzgjidhet për intervistë. Duke e pasur parasysh mostrën e shfrytëzuar për këtë studim, mund të themi në përgjithësi se rezultatet e hulumtimit e pasqyrojnë trendin e qëndrimeve dhe të perceptimeve të krejt popullatës së moshës së rritur të Kosovës. Si rrjedhojë, margjina e gabimit është 3 për qind ndërsa intervali i besimit është mbi 95 për qind.

Vlen të theksohet se para fillimit me pjesën e hulumtimit në terren, respektivisht në mesin e muajit shtator të vitit 2016, ekipi hulumtues fillimisht kishte zhvilluar intervista pilotuese me qëllim që të testimit të realizueshmërisë së pyetësorit. Pilotimi kishte rezultuar të jetë i suksesshëm, pa hasur në ndonjë problem me pyetjet e bëra ndaj të intervistuarit, duke shërbyer kështu si dritë e gjelbër për fillimin e anketimit. Ndërkohë, të gjitha intervistat e këtij edicioni të KSB u realizuan gjatë dy javëve të para të muajit tetor 2016. Përpunimi dhe analizimi i të dhënave u realizua me softuerin SPSS.

Perceptimet e paraqitura në këtë raport janë përmbledhje e informatave të marra prej të anketuarve, dhe e paraqesin perceptimin e personave të anketuar ndaj institucioneve të përfshira në studim. Andaj, raporti nuk është ndonjë vlerësim përfundimtar i cilësisë së punës në institucionet që janë subjekt i këtij studimi. Qëllimi i QKSS-s, me botimin e këtij raporti, është që t'i interpretojë perceptimet, pra të shtjelloj atë se "cili është qëndrimi" i qytetarëve të Kosovës në lidhje me sferave e identifikuar me pyetësorit. Ekipi i QKSS-s nuk merr përgjegjësi për rezultatit e të dhënave të grumbulluara, posaçërisht nëse ato kurdoherë nxitin ndonjë reagim të palëve të caktuara. Ndërkohë, për çfarëdo shqetësimi të ngritur ekipi mbetet gjithnjë i gatshëm që ta bëjë transparent tërë procesin e anketimit dhe metodologjinë e përdorur.

BAROMETRI KOSOVAR I SIGURISË (BKS) 2016: GJETJET KRYESORE

Besimi kundrejt institucioneve të sigurisë dhe të drejtësisë:

- Me 77 për qind, këtë vit zjarrfikësit rezultuan të jenë institucioni më i besueshëm. Të gjitha komunitetet në Kosovë e kanë shprehur besimin e tyre karshi këtij institucioni, me theks të veçantë në komunat veriore të Kosovës. Më pas vjen Forca e Sigurisë e Kosovës, si institucioni i dytë më i besueshëm me 72 për qind. Përkundër që kësaj radhe FSK rezultoi në vend të dytë, ky institucion ka shënuar rezultatin më të lartë sa i përket besueshmërisë të regjistruara ndonjëherë në kuadër të edicioneve të BKS-s;
- Policia e Kosovës (me 56 për qind) vazhdon ta ruajë imazhin e saj si një ndër forcat më të besueshme policore në rajon, kur e krahasojmë me barometrat rajonale. Ndërkohë, besimi i publikut ndaj Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë vazhdon të jetë i ulët, pjesërisht për shkak të mungesës së njohurive për këtë institucion;
- Përderisa besimi ndaj KFOR-it ka rënë paksa (prej 63 për qind në vitin 2015 në 58 për qind në vitin 2016), ai megjithatë mbetet misioni më i besueshëm ndërkombëtar. Thirrjet publike për vazhdimin e mandatit të KFOR-it demonstrojnë besim, por edhe ndjenjë të sigurisë publike si një institucion lokal i mbrojtjes;
- Besimi ndaj EULEX-it mbetet i ulët;
- Deri në 67 për qind e të anketuarve kanë deklaruar se nuk kanë besim në qeverinë e Kosovës. Po kështu edhe mos-besueshmëria i qytetarëve ndaj Kuvendit të Kosovës është i lartë, ku 66 për qind të tyre nuk i besojnë atij;
- Në fund, sa i përket komunave, KSB ka hasur në opinione të ndara të qytetarëve: 40 për qind e të anketuarve kanë deklaruar se nuk u besojnë komunave të tyre në krahasim me 34 për qind që janë shprehur se u besojnë.

Perceptimet sa i përket rreziqeve/sfidave të brendshme dhe të jashtme:

- Afërsisht 94 për qind e të anketuarve e kanë renditur papunësinë si sfidën më serioze për sigurinë kombëtare të Kosovës;
- Të anketuarve edhe korrupsionin (me 93 për qind) dhe krimin e organizuar e organizuar (me 90 për qind) shohin si kërcënim për sigurinë kombëtare, gjë që do duhej shërbyer si thirrje ndaj qeverisë për t'u marrë më aktivisht me eliminimin e këtyre dy sfidave;
- Ndërsa, pak më shumë se 80 për qind e të anketuarve konsiderojnë që paqëndrueshmërinë e vazhdueshme politike është po ashtu kërcënim i madh, duke u radhitur për 10 për qind më lart në krahasim me ata që e konsiderojnë ekstremizmin e dhunshëm si kërcënim;
- ISIS-i konsiderohet si kërcënimi më i madh i jashtëm për sigurinë kombëtare nga 66 për qind e të anketuarve, duke e lënë në renditje të dytë kërcënimin prej Serbisë (me 59 për qind);
- Të anketuarit ndjehen më pak të shqetësuar nga fatkeqësitë natyrore, ku vetëm 48 për qind e tyre i shohin ato si kërcënime. Megjithatë, përhapja e sëmundjeve pandemike globale paraqet shqetësim për 61 për qind e të anketuarve.

KAPITULLI I:

1. BKS 2016: BESIMI NDAJ INSTITUCIONEVE TË SIGURISË DHE TË DREJTËSISË

Matja e besimit të publikut është një prej treguesve më të rëndësishëm që e pasqyron cilësinë e performancës së institucioneve në përgjithësi. Si i tillë, është një mekanizëm i cili përdoret gjithandej për ta matur qeverisjen e mirë të një institucioni të caktuar duke u bazuar këndvështrimin e qytetarëve. Kjo për faktin se besueshmëria ekzistuese në një masë të madhe, e pasqyron performancën aktuale të institucioneve në fjalë. Në anën tjetër, besimi në institucione pasqyron kënaqshmërinë e qytetarëve në përgjithësi me mjedisin e tyre ekonomik, shoqëror dhe politik, gjë të lidhet ngushtë me performancën e elitave institucionale dhe politike në vend.

Së këndejmi, kapitulli për matjen e besimit përbën një prej shtyllave kryesore të BKS-s. Ash-tu si herëve të kaluara, edhe gjatë këtij viti (2016) qëllimi i këtij kapitulli është matja e be-simit të qytetarëve ndaj institucioneve të sigurisë dhe të drejtësisë. Gjithashtu, edhe kësaj radhe përzgjedhja e institucioneve bazohen në një qasje gjithëpërfshirëse të sektorit të sigurisë. Pra, BKS-s 2016 vazhdon traditën e tij duke mos u kufizuar vetëm në institucionet tradicionale të sigurisë, si Policia e Kosovës (PK), Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK), Agjencia e Kosovës për Inteligjencë (AKI) dhe zjarrfikësit, KFOR-i si forcë e udhëhequr prej NATO-s, dhe Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë (EULEX). Kjo pasi që edhe në këtë edicion do të ofrohet një perspektivë e gjerë të institucioneve të cilat KSB mbulon, ku përfshihen edhe institucione të tjera të rëndësishme si: prokurorisë, gjykatave, qeverisë së Kosovës, Kuvendit të Kosovës dhe komunave.

1.1. Besimi ndaj institucioneve të sigurisë

Rezultatet tregojnë se besimi i qytetarëve ndaj institucioneve të sigurisë mbetet dukshëm më i lartë në krahasim me institucionet e tjera publike. Kjo gjetje e këtij edicioni nuk pa-raqet aspak befasi pasi që edhe në edicionin e BKS-së të vitit 2015 patëm një rezultate të ngjashme.¹ Megjithatë, kur flasim për besueshmërinë e qytetarëve në sektorin e sigurisë kjo nuk do të thotë se nuk ka pasur ndonjë lëvizje.

¹ Shih Barometrin Kosovar të Sigurisë, Edicioni i rregullt vjetor 2015, Qendra Kosovare për Studimet të Sigurisë (QKSS), Prishtinë, dhjetor 2015

Në këtë rast, rezultati më befasues kishte të bënte me zjarrfikësit, të cilët edhe kësaj radhe janë përfshirë si një njësi e ndarë², e që rezultuan të jenë pa dyshim institucioni më i besueshëm në Kosovë. Më saktësisht, 77 për qind e të anketuarve u deklaruan se u besojnë zjarrfikësve, duke nënkuptuar kështu njëkohësisht një rritje të besimit prej 10 për qind në krahasim me rezultatet e vitit 2015. Perceptimi ndaj këtij institucioni duket se nuk bazohet në përvojën e qytetarëve me ta. Më shumë bazohet në solidarizimin e tyre sa i përket bindjeve të përgjithshme në lidhje me kushtet e vështira në të cilat zjarrfikësit punojnë, dhe për shkak të detyrave të rrezikshme që kanë, ku ata duhet të ndërhyjnë në të gjitha llojet e rreziqeve natyrore dhe të shkaktuara prej njeriut. Në anën tjetër, rritja e besueshmërisë ndaj këtij institucioni vjen edhe si rezultat i besimit të pakursyer që kanë pakicat për këtë institucion, të shprehur në mënyrë të vazhdueshme.

Ndërkohë, kësaj radhe FSK-ja është renditur në vendin e dytë si institucioni më i besueshëm në Kosovë. Megjithatë, përkundër faktit që kësaj radhe nuk udhëheq si institucioni më i besueshëm në Kosovë, rezultatet, tregojnë se gjatë 12 muajve të kaluar besimi i publikut ndaj FSK-së kishte gëzuar rritje me më shumë se 5 për qind në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit kaluar 2015. Pra, këtë vit (2016) janë 72 për qind e të anketuarve që i besojnë FSK-së, duke shënuar përqindjen më të lartë të besueshmërisë që ky institucion e ka gëzuar deri më tani në serine 5 vjeçare të matjes së perceptimeve nga ana e BKS-s.³ Ky rezultat ndër të tjera pasqyron performancën e përgjithshme pozitive të FSK-së⁴ si dhe vlerësimin e përgjithshëm të qytetarëve të Kosovës për këtë strukturë të uniformuar vendore. Mirëpo, sikurse edhe në edicionet e mëhershme, arsye tjetër se pse një numër kaq i madh i qytetarëve kanë treguar besim ndaj FSK-së buron edhe prej ndjenjës së përgjegjësisë që kanë qytetarët e Kosovës për procesin e transformimit të FSK-së në Forcë të Armatosua të Kosovës (FAK).⁵ Me rëndësi është të theksohet se qytetarët kanë filluar të shqetësohen edhe në lidhje me zotimin e institucioneve të Kosovës për transformimin e FSK-së në FAK ku vetëm 55 për qind e të anketuarve kanë thënë se janë të kënaqur me angazhimin e qeverisë së Kosovës për këtë çështje.

Perceptimet ishin pozitive edhe ndaj PK-së, ku 56 për qind e të anketuarve deklaruan se i besojnë këtij institucioni. Për më tepër, PK edhe më tutje vazhdon të krahasohet me institucionet simotra në rajon, duke u renditur si një ndër forcat më të besueshme nga ana e

2 Zjarrfikësit në Kosovë veprojnë në kuadër të Agjencisë për Menaxhimin Emergjent, Ministria e Punëve të Brendshme (MPB)

3 Barometri Kosovari i Sigurisë (BKS) ka nisur të aplikohet për herë të parë nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë në dhjetor të vitit 2012. Deri më tani ajo i ka realizuar 5 anketa vjetore, duke i vënë në pah, që pesë vjet radhazi, rezultatet e besimit të qytetarëve ndaj institucioneve të sigurisë dhe të drejtësisë.

4 Shih po ashtu raportin e monitorimit të QKSS-s për "Monitorimin dhe vlerësimin e integritetit dhe qeverisjes së brendshme në Ministrinë e Forcës së Sigurisë dhe në Policinë e Kosovës", të botuar më 26 maj 2016, në të cilin vlerësohet në detaje integriteti i Ministrisë së Forcës së Sigurisë dhe të Policisë së Kosovës: <http://www.qkss.org/en/Reports/Monitoring-and-Assessing-the-integrity-and-internal-governance-in-the-Ministry-of-Kosovo-Security-Force-and-the-Kosovo-Police-700>


5 Fokus grupi me hulumtuesit e terrenit për Barometrin Kosovari të Sigurisë (BKS) për edicionin vjetor 2016, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, 31 tetor 2016.

qytetarëve.⁶ Vlen të përmendim se PK-ja edhe në këtë vit mbetet një prej institucioneve që qytetarët e Kosovës kanë pasur më së shumti kontakt me të, ku 28 për qind e të anketuarve kanë deklaruar se kanë pasur kontakte me PK-në gjatë 12 muajve të vitit 2016.

Ndërsa për ta përmbyllur me institucionet vendore të sigurisë, mund të themi se perceptimi i qytetarëve ndaj AKI-së vazhdon të jetë i ulët. Kjo gjendje mund të shpjegohet me mungesën e njohjes së opinionit publik sa i përket rolit të veçantë që e ka ky institucion (duke e pasur parasysh mandatin e saj të klasifikuar), por edhe për shkak të perceptimit të trashëguar nga e kaluara, duke i shfaqur kështu mangësitë që i ka.

Në fund, rezultatet kanë demonstruar se KFOR-i mbetet një ndër institucionet më të besueshme ndërkombëtare në Kosovë. Së këndejmi, më shumë se 58 për qind e të anketuarve janë shprehur se i besojnë KFOR-it.⁷ Vlen të theksohet se rezultati paraqet rënie të besueshmërisë prej 5 për qind në krahasim me ato të periudhës së njëjtë të vitit 2015. Megjithatë, kjo rënie nuk paraqet ndonjë zhvillim negativ në lidhje me qëndrimin e qytetarëve ndaj KFOR-it. Përkundrazi, qytetarët sërish janë shprehur qartë se KFOR-i edhe më tutje duhet të vazhdojë të jetë i pranishëm në Kosovë. Në të vërtetë, në vitin 2016 rreth 43 për qind e të anketuarve deklaruan se KFOR-i nuk duhet të largohet kurrë nga Kosova, që përbënë një rritje prej 5 për qind në krahasim me 1 vit më parë. Për më tepër, së paku edhe 33 për qind të tjerë ishin shprehur se KFOR-i duhet të vazhdojë të qëndrojë në Kosovë edhe për së paku 2 deri në 3 vjetët e ardhshme.

BKS 2016: Besimi ndaj institucioneve të sigurisë



6 Opinioni i qytetarëve për forcën e policisë: analizë krahasuese e opinionit publik në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Mal të Zi, Kosovë, Maqedoni dhe Serbi, botim rajonal, shtator 2016, <http://pointpulse.net/wp-content/uploads/2016/09/POINTPULSE-2016-WB-ENG.pdf>

7 Barometri Kosovar i Sigurisë, Edicioni i rregullt vjetor 2015, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS), dhjetor 2015, http://www.qkss.org/repository/docs/Kosovo_Security_Barometer_-_Fifth_Edition_523670.pdf

1.2. Besimi ndaj institucioneve të drejtësisë

Sektori i drejtësisë në Kosovë vazhdoi të ishte i brishtë edhe gjatë vitit 2016. Kjo vlen jo vetëm për institucionet vendore të drejtësisë, por edhe për ELUEX-in, i cili i ka tashmë pothuajse krejtësisht mandatin e ka te orientuar në komponentën e drejtësisë.

Sipas rezultateve të BKS 2016, rreth 51 për qind e të anketuarve kanë theksuar se nuk i besojnë gjykatave vendore. Kjo mund të shihet si një shqetësim i radhës, i cili po përsëritet gati për çdo vit. Në fakt, rezultate e këtij viti në lidhje me gjykatat rezultuan të jenë identike me ato të edicionit të vitit paraprak të BKS-s.⁸ Përsëri, vetëm 22 për qind e të anketuarve kishin deklaruar se u besojnë këtyre institucioneve kryqë të drejtësisë. Rezultat i tillë konfirmon se edhe gjatë 12 muajve të fundit (2016), gjykatat e Kosovës dështuan ta ndërmarrin ndonjë hap konkret i cili do t'i bindte qytetarët e Kosovës në lidhje me fuqizimin e sektorit të drejtësisë. Andaj si pasojë e kësaj gjendjeje, frika nga krimi i organizuar dhe korrupsioni vazhdon të mbetet në nivele tejet të larta. Po ashtu edhe rastet kur qytetarët vendosin të marrin drejtësinë në dorën e vetë kanë shënuar rritje.⁹ Andaj, ky rezultat duhet të shërbej si alarm për përmirësime të menjëhershëm të sistemit të drejtësisë në Kosovë për t'u siguruar që të mos përkeqësohet edhe më tej gjendja e sundimit të ligjit në vend.

Në anën tjetër, besimi i qytetarëve rezulton të jetë i ulët edhe kur flasim për prokurorinë, e cila është shtyllat tjetër kryesore e sektorit të drejtësisë dhe të sundimit të ligjit në vend. Pra, këtë vit 46 për qind e të anketuarve deklaruan se nuk i besojnë prokurorisë, duke shënuar një rritje mosbesimi prej 6 përqindësh në krahasim me periudhën e njëjtë në vitin e kaluar.¹⁰

Kurse, EULEX-i që njihet si misioni më i madh i udhëhequr ndonjëherë në kuadër të *Politikave të Përbashkëta të Mbrotjes dhe Sigurisë* që BE-ja vazhdon të jetë një mision jo popullor në Kosovë, duke u renditur madje edhe më keq se sa gjykatat dhe prokuroria vendore. Së këndejmi, më shumë se 53 për qind e të anketuarve kanë shprehur mosbesim ndaj misionit të EULEX-it. Një prej arsyeve se pse nuk i besojnë qytetarët EULEX-it është reputacioni i dobët që e ka ky mision për shkak të skandaleve të supozuara të korrupsionit që dolën në dritë gjatë vitit 2014 dhe 2015.¹¹ Përveç kësaj, mosbesimi i qytetarëve mund të lidhet edhe me dështimin e EULEX-it për t'i përmbushur pritjet e tyre që i kishin në fillim të mandatit

8 Barometri Kosovari i Sigurisë, Edicioni i rregullt vjetor 2015, Qendra Kosovare për Studimet të Sigurisë (QKSS), dhjetor 2015, http://www.qkss.org/repository/docs/Kosovo_Security_Barometer_-_Fifth_Edition_523670.pdf


9 Rikthimi i "ligjit" të Kanunit në Kosovë, gjashtë vrasje brenda javës, Telegrafi, gusht 2016 <http://telegafi.com/rikthimi-ligjit-te-kanunit-ne-kosove-gjashte-vrasje-brenda-javes/>

10 Shih Barometrin Kosovari të Sigurisë, Edicionin e rregullt vjetor 2015, të botuar nga Qendra Kosovare për Studimet të Sigurisë (QKSS), dhjetor 2015, http://www.qkss.org/repository/docs/Kosovo_Security_Barometer_-_Fifth_Edition_523670.pdf

11 Balkan Insight, Skandal dhe dyshim në misionin e BE-së në Kosovë, Lajm, Nëntor 2014, <http://www.balkaninsight.com/en/article/scandal-and-suspicion-at-the-eu-s-kosovo-mission-1>

të misionit.¹² Mirëpo, rezultatet e BKS-s tregojnë se perceptimet e qytetarëve në lidhje me besueshmërinë ndaj EULEX-it ishin në kundërtënie me atë që qytetarët deklaruan sa i përket shkuarjes së këtij misioni nga Kosova. Në këtë rast t vetëm 44 për qind e të anketuarve u deklaruan se EULEX-i duhet të largohet nga Kosova. Në anën tjetër 52 për qind e të anketuarve ishin në favor të vazhimit të pranisë së tij edhe për një periudhë shtesë kohore¹³.

BKS 2016: Besimi ndaj institucioneve të drejtësisë



1.3. Besimi ndaj kuvendit dhe qeverisë së Kosovës

Përveç institucioneve tradicionale të sigurisë dhe të drejtësisë, edhe Kuvendi i Kosovës, qeveria e Kosovës dhe komunat kanë rol themelor për ofrimin e sigurisë, drejtësisë dhe të sundimit të ligjit. Në edicionet e mëhershme të BKS-s është theksuar se rëndësia e institucioneve ekzekutive si dhe e atyre legjislativë është strategjike dhe operacionale. Kjo nënkupton që këto institucione jo vetëm që kanë përgjegjëse për përcaktimin e të gjitha politikave në fushën e sigurisë dhe të drejtësisë të nivelit qendror dhe lokal në Kosovë, por ato edhe kanë rol të veçantë kur flasim për mandatin dhe rolin e tyre implementues duke marrë për bazë këtu konceptet gjithëpërfshirës të sektorit të sigurisë. Megjithatë, përkundër rëndësisë së tyre për ofrimin e një mjedisi të përgjithshëm të sigurt në fushën e sundimit të ligjit dhe të sigurisë, rezultatet e anketës tregojnë se besimi i qytetarëve ndaj këtyre institucioneve është më i ulëti. Pra, rezultatet qartazi ka vënë në pah faktin që Kosova tashmë ka hyrë në ngërç të thellë politik, duke vënë në pikëpyetje legjitimitetin e institucioneve kryesore të shtetit, si janë qeveria e Kosovës dhe Kuvendi i Kosovës.

Kështu, rezultatet e BKS 2016 tregojnë se besimi i qytetarëve ndaj Qeverisë së Kosovës dhe Kuvendit të Kosovës jo vetëm që është i ulët por këtë vit madje edhe kishte pësuar rënie. Respektivisht, 67 për qind e të anketuarve këtë vit u deklaruan se nuk i besojnë qeverisë së Kosovës, që është një rritje e mosbesimit prej 7 për qind ndaj këtij institucioni në kra-

12 Fokus grupi me hulumtuesit e terrenit për Barometrën Kosovare të Sigurisë (BKS) për edicionin vjetor 2016, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, 31 tetor 2016


13 Rreth 32 për qind e të anketuarve kanë deklaruar se EULEX-i duhet të qëndrojë në Kosovë edhe për 2 ose 3 vjet, ndërsa rreth 20 për qind e të anketuarve kanë deklaruar se EULEX-i nuk duhet të largohet kurrë nga Kosova.

hasim më periudhën e njëjtë kohore të vitit 2015.¹⁴ Andaj sipas gjetjeve të BKS-s, qeveria e Kosovës është institucioni më mosbesues në Kosovë.

Ndërkohë, perceptime të ngjashme sikurse në lidhje me Qeverinë qytetarët patën edhe ndaj Kuvendit të Kosovës, ku më shumë se 66 për qind e të anketuarve kanë deklaruar se nuk i besojnë institucionit të Kuvendit të Kosovës, përfaqësuesit e të cilit institucion janë të përzgjedhur drejtpërdrejtë nga qytetarët.

Kurse, për fund besueshmëria e qytetarëve sa i përket institucioneve komunale duket të jetë më e mire. Në këtë rast, rreth 34 për qind e të anketuarve kanë deklaruar se u besojnë komunave të tyre kundrejt 40 për qind që kanë deklaruar se nuk u besojnë autoriteteve të tyre komunale. Vlen të përmendim se këto rezultate janë mjaft normale kur e kemi parasysh se Kosova po i afrohet zgjedhjeve lokale në vitin 2017. Gjithashtu, rezultati në fjalë po ashtu dëshmon se komunat, në përgjithësi, nuk janë të afektuara edhe aq nga ngërçi politik, i cili i ka mbërthyer institucionet qendrore të shtetit.

BKS 2016: Besimi ndaj qeverisë, kuvendit dhe komunave



¹⁴ Shih Barometrin Kosovari të Sigurisë, Edicionin e rregullt vjetor 2015, të botuar nga Qendra Kosovare për Studimet të Sigurisë (QKSS), dhjetor 2015, http://www.qkss.org/repository/docs/Kosovo_Security_Barometer_-_Fifth_Edition_523670.pdf

KAPITULLI II

2. BKS 2016: PERCEPTIMI I QYTETARËVE NDAJ RREZIQEVE DHE KËRCËNIMEVE

Matja e perceptimeve të qytetarëve për kërcënimet e brendshme dhe të jashtme të sigurisë përbën po ashtu një prej qëllimeve kryesore të BKS-s.

Kosova është e ekspozuar ndaj kërcënimeve të ndryshme, të cilat përbëjnë shqetësim serioz për qytetarët e saj dhe mirëqenien e tyre. Këtu përfshihen këto shqetësime: shkalla e lartë e papunësisë; korrupsioni i përhapur gjithandej; krimi i organizuar; paqëndrueshmëria politike; rritja e ekstremizmit të dhunshëm; gjendja vazhdimisht e destabilizuar në veri të Kosovës; marrëdhëniet e tensionuara me Serbinë; ekspozimi ndaj katastrofave natyrore; përhapja e mundshme e epidemive globale; si dhe krizat ekonomike globale.

Siç mund të shihet, këto janë shqetësime që, mes tjerash, janë të lidhura ngushtë me performancën e institucioneve të shtetit. Andaj, krahas matjes së besimit për institucionet e sigurisë dhe të drejtësisë, edhe perceptimet ndaj rrezikut dhe kërcënimeve përbëjnë një kontribut shumë të rëndësishëm, duke i mundësuar BKS-s që t'i ofrojë audiencës së vet një mozaik gjithëpërfshirës të gjendjes socio-ekonomike, të sigurisë, të sundimit të ligjit dhe të asaj politike.

Në ndërkohë, qytetarët ndjehen më të kërcënuar prej kërcënimeve të brendshme sesa prej atyre të jashtme. Problemet e brendshme socio-ekonomike, siç janë shkalla e lartë e papunësisë, korrupsioni dhe krimi i organizuar, kanë dalë të jenë çështjet më problematike, ku mbi 90 për qind e të anketuarve janë shprehur tejet të shqetësuar nga këto kërcënime, ndërsa menjëherë pas tyre vjen paqëndrueshmëria politike. Po kështu edhe ekstremizmi i dhunshëm dhe gjendja e destabilizuar në veri të Kosovës janë probleme sfiduese, të cilat i shqetësojnë qytetarët e Kosovës.

Në pjesën në vijim do të japim interpretime më të detajuara sa i përket kërcënimeve të brendshme dhe të jashtme.

2.1. Kërcënimet e brendshme ndaj sigurisë kombëtare

KBS 2016: të ardhurat personale sipas deklarimit të të anketuarve	
Kanë kundërshtuar të përgjigjen	28%
Prej 0-120 €	31%
Prej 120- 250 €	14%
Prej 250-500 €	22%
Prej 500-800 €	3%
Më shumë se 800 €	2%

Gjetjet tregojnë se 94 për qind e të anketuarve e konsiderojnë papunësinë si sfidën më të madhe për sigurinë kombëtare të Kosovës. Kjo është një shifër shumë e lartë që tregon se Kosova vazhdon të jetë tejet e brishtë kur flasim për mundësinë e trazirave socio-ekonomike. Është një sinjal që tregon se qytetarët e Kosovës janë duke jetuar me një standard ekonomik të një niveli mjaft të ulët. Për më tepër, kjo konfirmohet edhe me të dhënat e mbledhura nga të anketuarit përmes anketës, sipas të cilave më shumë se 31 për qind e tyre kanë deklaruar se marrin prej 0 deri 120 euro në muaj. Duke e pasur parasysh se shumtë e tilla të të ardhurave janë krejt afër kufirit të varfërisë globale, ato tregojnë se një pjesë e madhe e qytetarëve të Kosovës jetojnë në kushte të vështira financiare. Në ndërkohë, vetëm 5 për qind e të anketuarve kanë deklaruar se marrin më shumë se 500 euro në muaj. Të anketuarit kanë thënë se mungesat në të ardhura mbulojnë rregullisht prej remitancave. Deklarimi i të ardhurave nuk mund të verifikohet si i tillë, por mund t'i prijë interpretimit tonë dhe perceptimit të qytetarëve lidhur me sfidat e ndryshme të sigurisë.

Korrupsioni dhe krimi i organizuar janë renditur menjëherë pas papunësisë, duke e parë atë si një kërcënim të brendshëm dhe tejet serioz ndaj sigurisë. Si rrjedhojë, më shumë se 93 për qind e të anketuarve kanë deklaruar se korrupsioni paraqet kërcënim të madh për sigurinë kombëtare të Kosovës, ndërsa 90 për qind të tyre janë shprehur se krimi i organizuar është shqetësimi i tretë më i madh sa i përket kërcënimeve të brendshme të sigurisë. Shkalla e lartë e perceptimit për korrupsionin dhe krimin e organizuar përkon edhe me shkallën e ulët të besimit të qytetarëve ndaj institucioneve ekzekutive dhe juridike të Kosovës. Na jep një bazë për të menduar se si qeveria e Kosovës ashtu edhe gjyqësori kanë dështuar të ndërmarrin ndonjë hap të vendosur, i cili do të mund t'ua demonstronte qytetarëve se i kanë ndërmarrë hapat themelorë për t'i luftuar këto dukuri. Përkundrazi, qytetarët vazhdojnë të besojnë se këto sfida të mëdha janë të lidhura thellë me organet e nivelit të mesëm dhe të lartë të qeverisë dhe të gjyqësorit, e që reflektohet me mungesën e vullnetit për t'i parandaluar dhe për t'i luftuar këto dukuri. Për më tepër, mungesa e vullnetit politik


si dhe paaftësia e institucioneve përkatëse që të nxjerrin rezultate të prekshme për luftimin e kimit të organizuar dhe të rasteve të korrupsionit në Kosovë ka ndikuar drejtpërdrejt te perceptimi i publikut, i cili ka shfaqur një shkallë të lartë të mosbesimit ndaj institucioneve të shtetit, duke i përfshirë edhe organet ekzekutive dhe ato të gjyqësorit.

BKS 2016 tregon se paqëndrueshmëria politike perceptohet prej qytetarëve si një kërcënim tejet shqetësues. Kjo duket se vjen kryesisht për shkak të veprimeve të partive opozitare, të cilat në mënyrë të hapur e kundërshtojnë miratimin e marrëveshjes së Brukselit për bashkësinë e komunave me shumicë serbe në Kosovë, si dhe marrëveshjen e demarkacionit të kufirit me Malin e Zi, të nënshkruar nga përfaqësuesit e qeverisë së Kosovës pa konsensusin paraprak edhe të partive të tjera opozitare. Kjo ka shkaktuar një gjendje kaotike në Kosovë pasi as partitë në pushtet, e as opozita nuk kanë treguar vullnet që ta gjejnë një zgjidhje me konsensus që të tejkalohen kontestet për këto dy marrëveshje. Për pasojë, kjo ka krijuar indinjatë dhe zhgënjim te qytetarët, e që është reflektuar në rezultatet e BKS 2016, ku 80 për qind e të anketuarve e konsiderojnë gjendjen e tensionuar politike si një kërcënim të madh për sigurinë e brendshme të vendit.

Është me rëndësi të cekim se qytetarët kanë një perceptim të një shkalle më të ulët kur flasim për ekstremizmin e dhunshëm dhe gjendjen e destabilizuar. Rreth 70 për qind e të anketuarve janë përgjigjur se ekstremizmi i dhunshëm përbën kërcënim për sigurinë kombëtare të Kosovës. Përveç kësaj, 72 për qind e të anketuarve e shohin gjendjen në veriun e Kosovës si një kërcënim serioz kombëtar. Rezultatet për këto dy kërcënimet e fundit janë interesante pasi që të dy këto sfida e kanë pasur vëmendjen e ngjashme të publikut gjatë 12 muajve të vitit 2016. Në njërën anë, dialogu i lehtësuar prej BE-s mes Kosovës dhe Serbisë, si dhe zbatimi i marrëveshjeve që burojnë prej dialogut kanë stagnuar gjatë kësaj periudhe, ndërsa në anën tjetër, çështjet që kanë të bëjnë me luftimin e ekstremizmit të dhunshëm vazhdojnë të jenë ndër temat kryesore të diskursit të opinionit publik. Kjo duket se buron prej faktit meqë ekstremizmi i dhunshëm është bërë një problem që ka fituar vëmendje në shkallë globale. Ndërsa gjendja në veri të Kosovës deri më tani është shqyrtuar në kuadër të dialogut të lehtësuar nga BE-ja mes Kosovës dhe Serbisë.

Në fund, rezultatet e BKS-s tregojnë se qytetarët e Kosovës ndjehen më pak të shqetësuar ndaj kërcënimeve, të cilat nuk shkaktohen prej fuqisë njerëzore. Së këndejmi, vetëm 48 për qind e të anketuarve kanë deklaruar se rreziqet natyrore përbëjnë kërcënim të madh për sigurinë kombëtare të Kosovës. Janë këto rezultate përkundër që Kosova gjatë 12 muajve të vitit 2016 është përballur disa herë me vërshime, të cilat kanë shkaktuar dëme në disa zona të caktuara. Njëherësh, gjatë stinës së verës vendi është përballur rregullisht me zjarre, dhe se territori i Kosovës konsiderohet si një zonë aktive tektonike. Përveç kësaj, Kosova është e ekspozuar edhe ndaj dukurive të tjera shkatërruese, si ortekët, rrëshqitjet e dheut, dimra të fortë dhe thatësira. Megjithatë, duket se qytetarët janë përshtatur me këto kushte natyrore. Andaj, rreziqet natyrore nuk u panë si sfida kundrejt kërcënimeve që burojnë prej dorës së njeriut.

BKS 2016: Përceptimi i qytetarëve ndaj kërcënimeve të brendshme dhe natyrore të sigurisë



2.2. Kërcënimet e jashtme për sigurinë kombëtare

Edhe pse Kosova vazhdon të jetë vend relativisht i qëndrueshëm, ajo vazhdon të ju ekspozohet kërcënimeve të jashtme të cilat rrezikojnë sigurinë kombëtare të saj, e të cilat kanë origjinë qoftë rajonale, globale apo edhe të dyja njëkohësisht. Në parim, lista e kërcënimeve me të cilët ajo ballafaqohet është relativisht e gjerë. Megjithatë, BKS-ja është përpjekur që ta ngushtojë numrin e indikatorëve duke u fokusuar vetëm në katër burimet më problematikë me të cilat ballafaqohet Kosova. Andaj, BKS-ja serbisht ka matur perceptimet e qytetarëve ndaj kërcënimeve që burojnë nga: organizata terroriste të ashtuquajtur Shteti Islamik i Irakut dhe Sirisë (ISIS), epidemive në shkallë botërore, krizave ekonomike globale dhe Serbia.

Kur flasim për ISIS-in, rezultatet e BKS-s tregojnë se qytetarët e Kosovës e konsiderojnë atë si kërcënimin më të madh të jashtëm i cili i drejtohet sigurisë kombëtare në vend. Respektivisht, sipas rezultateve të BKS-s, rreth 66 për qind e të anketuarve e konsiderojnë ISIS-in si kërcënim të madh ndaj sigurisë kombëtare. Kjo vjen kryesisht si rezultat i reputacionit të keq që e ka krijuar kjo organizatë terroriste në nivelin global. Mirëpo, kjo vjen edhe si pasojë e asaj që qytetarët gjithnjë e më shumë po vetëdijesohen lidhur me kërcënimet që vijnë prej propagandës që e shfrytëzon kjo organizatë terroriste. Andaj, ata janë të informuar mjaftë mirë se kërcënimin që e paraqet ISIS nuk kufizohet vetëm në nivelin strategjik global, por ndikon edhe në nivelin vendor dhe rajonal. Në veçanti, qytetarët janë të vetëdijshëm për faktin se ISIS-i shërben aktualisht si frymëzim i madh për përhapjen e ideologjisë së ekstremizmit të dhunshëm si në Kosovë ashtu edhe në vendet fqinje.

Në anën tjetër, përveç ekstremizmit, qytetarët kanë shprehur frikë edhe sa i përket ndikimit të krizave ekonomike globale në Kosovë, ku rreth 62 për qind e të anketuarve kanë thënë se krizat ekonomike globale janë rrezik serioz për sigurinë kombëtare të Kosovës. Kjo tregon që një ndër brengat kryesore të qytetarëve të Kosovës është aspekti ekonomik i sigurisë. Gjithashtu ky rezultat vënë në pah edhe faktin se Kosova në masë të madhe varet nga remitencat dhe se viteve të fundit ka ulje të derdhjeve të fondeve nga diaspora në Kosovë. Si dhe në fund, ky rezultat spikat faktin që qytetarët tashmë janë të vetëdijshëm se si rezultat i amullisë ekonomike në botë kompanitë e huaja gjithnjë e më pak po shprehin interesim që të investojnë në Kosovë.

Tjetër gjendje interesante e KSB 2016 është edhe fakti që 60 për qind e të anketuarve kanë deklaruar se përhapja e pandemive globale përbën kërcënim madhor ndaj sigurisë kombëtare të vendit. Duke e pasur parasysh zgjerimin e globalizimit dhe rolin në rritje të medias, mund të thuhet se qytetarët e Kosovës janë ndikuar nga raportimet mediatike në lidhje me rrezikun që paraqet ky fenomen. Siç dihet, gjatë vitit 2016, pandemia më e përfolur ishte ajo e virusit 'zika', e cila u përhap në pjesë të ndryshme të globit.¹⁵ Megjithatë, në bazë të hulumtuesve në terren shfaqja e këtij virus nuk ishte arsyeja e vetme se pse qytetarët kishin shprehur shqetësimet e tyre.¹⁶ Shqetësimet e tyre ishte më i përgjithësuar dhe përfshinte sëmundjet pandemike në përgjithësi, të cilat qytetarët frikësohen se do të mund të shpërndareshin gjithandej globit, dhe që Kosova domosdo to të prekej po ashtu.

Për fund, edhe pse qytetarët shprehën shqetësime sa i përket kërcënimit të jashtëm që e ka zanafillën nga rajoni, çuditërisht intensiteti i këtyre shqetësimeve ishte më i vogël se sa ato me impakt të gjerë global. Pra, befasisht në bazë të rezultateve të KSB 2016 qytetarët konsiderojnë Serbinë të jetë kërcënim më i ulët në krahasim me kërcënimet e përmendura më herët. Si duket qytetarët nuk e parashohin mundësinë e përfshirjes së Serbisë në veprime të drejtpërdrejta armiqësore ndaj Kosovës, pra si një kërcënim të madh dhe të pashmangshëm për të. Përkundër kësaj, rreth 60 për qind e të anketuarve vazhdojnë të mendojnë që Serbia ende përbën rrezik madhor ndaj sigurisë kombëtare të Kosovës.¹⁷


Në diagramin më poshtë mund të gjeni një pasqyrë të detajuar sa i përket rreziqeve të jashtme sipas katër treguesve.

15 Organizata Botërore e Shëndetësisë, Profili i virusit zika, i përditësuar më 6 shtator 2016, në: <http://www.who.int/mediacentre/factsheets/zika/en/>

16 Fokus grupi me hulumtuesit e terrenit për Barometrin Kosovare të Sigurisë (BKS) për edicionin vjetor 2016, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, 31 tetor 2016

17 Duhet të përmendim se puna hulumtuese në terren u realizua para se të ndodhin arrestimet e fundit të dy qytetarëve të Kosovës (njëri prej të cilëve ishte zyrtar i lartë i Policisë së Kosovës) nga policia e Serbisë që ndodhi gjatë muajve tetorit-nëntorit të vitit 2016.

BKS 2016: Përceptimi për kërcënimet dhe rreziqet e jashtme ndaj sigurisë kombëtare



BIBLIOGRAFIA

Burimet e dorës së parë:

1. Baza e të dhënave të anketës së Barometrit Kosovar të Sigurisë, edicioni 2016. Anketë u realizua nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë gjatë dy javëve të para të muajit tetor 2016.
2. Barometri Kosovar i Sigurisë, raporti i edicionit të rregullt vjetor 2015, i botuar nga QKSS-ja, 16 dhjetor 2015
3. Fokus grupi me hulumtuesit e terrenit për Barometrën Kosovare të Sigurisë (BKS) për edicionin vjetor 2016, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, 31 tetor 2016

Burimet e tjera:

4. P. Avdiu dhe S. Perteshi, "Monitorimi dhe vlerësimi i integritetit të qeverisjes së brendshme në Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe në Policinë e Kosovës", Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS), 26 maj 2016, <http://www.qkss.org/en/Reports/Monitoring-and-Assessing-the-integrity-and-internal-governance-in-the-Ministry-of-Kosovo-Security-Force-and-the-Kosovo-Police-700>
5. Point pulse, "Opinion i qytetarëve për forcën e policisë: analizë krahasuese e opinionit publik në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Mal të Zi, Kosovë, Maqedoni dhe Serbi", botim rajonal, shtator 2016, <http://pointpulse.net/ep-content/uploads/2016/09/POINTPULSE-2016-ËB-ENG.pdf>
6. Barometri Kosovar i Sigurisë, Edicioni i rregullt vjetor 2015, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS), dhjetor 2015, http://www.qkss.org/repository/docs/Kosovo_Security_Barometer_-_Fifth_Edition_523670.pdf
7. Rikthimi i "ligjit" të Kanunit në Kosovë, gjashtë vrasje brenda javës), Portali i Lajme Online Telegrafi, Gusht 2016 <http://telegrafi.com/rikthimi-ligjit-te-kanunit-ne-kosove-gjashte-vrasje-brenda-javes/>
8. 8Balkan Insight, Skandal dhe dyshim në misionin e BE-së në Kosovë, lajm, nëntor 2014, <http://www.balkaninsight.com/en/article/scandal-and-suspicion-at-the-eu-s-kosovo-mission-1>

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

351.746.1(496.51)

Barometri Kosovar i Sigurisë / interpretimi i të dhënave Mentor Vrajolli,
Florian Qehaja. - edicioni i gjashtë Prishtinë : Qendra Kosovare për Studime të
Sigurisë, 2016. – 25 f. : ilustr. me ngjyra ; 21 cm.

1.Vrajolli, Mentor . 2. Qehaja, Florian

ISBN 978-9951-679-53-4

ISBN 978-9951-679-53-4



9 789951 679534

www.qkss.org